



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 9 korrik 2012
Nr. ref.: RK/268/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI13/12

Parashtruesi

Shqiprim Qeriqi dhe Rizah Qeriqi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës
Rev. Nr. 443/2009, të datës 8 dhjetor 2011**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Ivan Čukalović, gjyqtar

Parashtruesit e kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë Shqiprim Qeriqi dhe Rizah Qeriqi, të cilët i përfaqëson Kryetari i sindikatës së SBASHK-ut, zotëri Rustem Bublica nga fshati Dobrajë e Madhe, Komuna e Lipjanit.

Kërkesa e parashtruesve të kërkesës

2. Kontestohet Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev nr. 443/2009, i datës 8 dhjetor 2011, me të cilin konfirmohet Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac. nr. 263/09, i datës 25 qershor 2009, dhe Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Lipjan C. nr. 17/2008, i datës 19 qershor 2008, dhe refuzohet si e papranueshme kërkesëpadija e parashtruesve të kërkesës, punëtor të shkollës fillore „Faik Konica“, në fshatin Krojmir, që Ministria e Shërbimeve Publike - Drejtoria e Arsimit e Komunës së Lipjanit për punën e kryer t'u paguajë parashtruesve të kërkesës të ardhurat personale, me kamatë, duke filluar nga 1 shkurti 2008, deri në kohën e pagesës përfundimtare, si dhe njëkohësisht t'u kompensojë atyre shpenzimet procedurale, në afat prej 8 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi e këtij Aktvendimi, me kërcënimin e ekzekutimit me forcë.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes, kontesti nga marrëdhënia e punës mes parashtruesit të kërkesës dhe Ministrisë së Shërbimeve Publike – Drejtoria e Arsimit e Komunës së Lipjanit, është krijuar si pasojë e mospagesës së të ardhurave personale. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev nr. 443/2009, të datës 8 dhjetor 2011, duke theksuar se me këtë Aktgjykim parashtruesve të kërkesës u është shkëlur e drejta themelore nga neni 24 (Barazia para ligjit) i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe neni 154 LMD(Ligji për marrëdhëniet detyimore) i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Protokolli 1, neni 6 .

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 16 dhjetorit 2008 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 56 paragrafi 2 të Rregullore së punës.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 9 shkurt 2012, parashtruesit e kërkesës i paraqitën kërkesën Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 15 shkurt 2012, Gjykata Kushtetuese ka njoftuar parashtruesit e kërkesës dhe Gjykatën Supreme të Kosovës se ka filluar procedura e vlerësimit të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit për lëndën Nr. KI-13-12.
7. Më 2 korrik 2012, pas shqyrtimit të raportit paraprak të gjyqtarës Snezhana Botusharova, Kolegji shqyrtues i përbërë nga: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Prof.dr. Ivan Čukalović, i rekomanduan Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

8. Parashtruesit e kërkesës kanë ushtruar padi në Gjykatën Komunale në Lipjan kundër të paditurve: Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Lipjanit dhe Ministrisë së Shërbimeve Publike në Prishtinë, për kompensim të të ardhurave personale gjatë kampanjës parazgjedhore për KK të Lipjanit.
9. Në kërkesëpadi si dhe në seancat dëgjimore para Gjykatës Komunale në Lipjan, parashtruesit e kërkesës theksuan se punëtorët e arsimit në shkollën fillore „Faik Konica“ në fshatin Krojmir, kanë paraqitur kandidaturat për funksion të zgjedhur publik pranë KK të Lipjanit, dhe se kanë kryer aktivitete parazgjedhore në periudhën e

muajit nëntor dhe dhjetë ditët e para të muajit dhjetor 2007, por se këtë aktivitet parazgjedhor e kanë kryer pa ndërprerë marrëdhënien e punës, ashtu që punët dhe përgjegjësitë e arsimtarëve gjatë kësaj kohe i kanë kryer pa humbur orët e mësimi.

10. Më pastaj, ata theksuan se askush nuk i ka njoftuar lidhur me obligimet ligjore se aktivitetin parazgjedhor duhet kryer duke marrë pushim pa pagesë, ngase po të kishin të tilla njohuri ata në asnjë mënyrë nuk do të vendosnin të paraqisnin kandidaturat për funksion të zgjedhur publik. Meqenëse gjatë aktivitetit parazgjedhor, njëkohësisht edhe kanë mbajtur orët mësimore, ata konsiderojnë se u takojnë të ardhurat personale të marrëdhënies së punës për periudhën e kontestuar, për çka edhe i kanë propozuar Gjykatës Komunale në Lipjan që gjykata të pranoj plotësisht kërkesëpadinë e tyre si të bazuar.
11. Duke vendosur lidhur me kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës, Gjykata Komunale në Lipjan përmes Aktgjykimit C.nr.17/2008, të datës 19 qershor 2008, ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës, me të cilën kanë kërkuar që të obligohen të paditurit për kompensim të të ardhurave personale për muajin nëntor dhe dhjetë ditët e para të muajit dhjetor 2007, për punën e kryer në cilësinë e punëtorëve të shkollës fillore „Faik Konica“ fshati Krojmir, me kamatë, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore me arsyetimin se:

“...vihet në përfundim se paditësit kanë qenë në marrëdhënie pune pranë shkollës fillore „Faik Konica“, në Krojmir, dhe se kanë paraqitur kandidaturat për funksione të caktuara publike pranë KK të Lipjanit në zgjedhjet që janë mbajtur më 17 nëntor 2007, dhe se të njëjtit kanë zhvilluar aktivitet parazgjedhor gjatë muajit nëntor dhe 10 ditët e para të muajit dhjetor 2007, pa e ndërprerë marrëdhënien e punës dhe se në të njëjtën kohë kanë mbajtur edhe orët mësimore të shkollës fillore ku kanë qenë në marrëdhënie pune gjatë periudhës kontestimore. Te një gjendje e këtillë e fakteve, e vërtetuar mbi bazën e provave të administruara në gjykatë, e duke iu referuar dispozitave ligjore në fuqi, gjykata vjen në përfundim se paditësit nuk kanë pasur mundësi ligjore që të njëjtën kohë të jenë në marrëdhënie të punës, por ata prej momentit kur kanë paraqitur kandidaturat për ndonjë funksion të zgjedhur publik, e duke filluar nga data kur ata publikisht i kanë shpallur kandidaturat e tyre, domosdo kanë qenë detyruar të marrin pushim pa pagesë nga shërbimi civil, respektivisht organizata e tyre (neni 28.4 i Urdhërësës Administrative nr. 23/2 mbi zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36 për Shërbimin Publik të Kosovës)”.
12. Ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Lipjan C.nr.17/2008, të datës 19 qershor 2008, parashtruesit e kërkesës ushtruan ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.
13. Me Aktgjykimin e Gjykatës Qarkut në Prishtinë Ac.nr. 263/2009, të datës 25 qershor 2009, u refuzua si e pabazuar ankesa e parashtruesve të kërkesës dhe u konfirmua Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Lipjan C.nr.17/2008, të datës 19 qershor 2008.
14. Ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Qarkut në Prishtinë Ac.nr.263/2009, të datës 25 qershor 2009, parashtruesit e kërkesës ushtruan kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës.
15. Me Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr.443/2009, të datës 8 dhjetor 2011, u refuzua si e pabazë kërkesa për revizion e parashtruesve të kërkesës, e

parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Qarkut në Prishtinë Ac.nr. 263/2009, të datës 25 qershor 2009.

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës

16. Parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se; *“me këto vendime të padrejta gjyqësore janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore nga neni 24 (Barazia para ligjit) i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe neni 154 LMD(Ligji për marrëdhëniet detyrimore) i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Protokolli 1, neni 6”.*
17. Këtyre pretendimeve parashtruesit e kërkesës u kanë bashkangjitur edhe Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Vushtrri C.nr. 85/08, të datës 18 prill 2008, dhe Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Podujevë E.nr.943/2008, të datës 1 prill 2009, me të cilat punëtorëve të arsimit, të cilët poashtu kanë marrë pjesë në zgjedhje, u është njohur e drejta në të ardhura personale pa marrë parasysh se kishin marrë pjesë në zgjedhje.
18. Parashtruesit e kërkesës i drejtohen Gjykatës Kushtetuese me kërkesën;
“Të miratohet kërkesëpadia dhe të ndryshohen të gjitha aktgjykimet e gjykatave më të ulëta”.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

19. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se neni 24. (Barazia para ligjit) i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe neni 6 (E drejta për një proces të rregullt) Protokolli 1 i KEDNJ, janë bazë për parashtruesin e tyre.
20. Neni 48 Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës parasheh:
“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”
21. Sipas Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e apelit, kur shqyrtohen vendimet e nxjerra nga ana e gjykatave të rregullta, çshtë detyrë e gjykatave të rregullta që të interpretojnë ligjet dhe zbatojnë rregullat e duhura të të drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, para. 28, [GJEDNJ ESLJP] 1999-I).
22. Parashtruesit e kërkesës nuk kanë paraqitur kurrfarë dëshmie *prima facie* që do të tregonte shkeljet e të drejtave të tyre kushtetuese (shih, Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, Vendimi i GJEDNJ-së në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës, nr. 53363/99, të datës 31 maj 2005). Parashtruesit e kërkesës nuk theksojnë se në çfarë mënyre neni 24 (Barazia para ligjit) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe neni 6 (E drejta për proces të rregullt) Protokolli 1 i KEDNJ, mbështesin kërkesën e tyre, siç parashihet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 48 të Ligjit.
23. Parashtruesit e kërkesës pohojnë se u janë shkelur të drejtat (Barazia para ligjit) dhe (E drejta për proces të rregullt) me zbatimin e gabueshëm të ligjit nga ana e gjykatave të rregullta, pa cekur qartë se në çfarë mënyre Aktgjykimi iu shkel të drejtat e tyre kushtetuese.
24. Në rastin konkret, parashtruesve të kërkesës u janë ofruar mundësi të shumta që të paraqesin rastin e tyre dhe të kontestojnë interpretimin e ligjit, që mendojnë se është i

gabuar, para Gjykatës Komunale në Lipjan, Gjykatës së Qarkut në Prishtinë si dhe Gjykatës Supreme. Pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk ka vërtetuar se procedurat përkatëse në çfarëdo mënyre kanë qenë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ lidhur me pranueshmërinë e kërkesës, nr. 17064/06, të datës 30 qershor 2009).

25. Përfundimisht, kjo kërkesë nuk i plotëson kushtet e pranueshmërisë. Parashtruesit e kërkesës nuk kanë arritur të tregojnë dhe mbështesin me dëshmi se, gjoja, me këtë Aktgjykim u janë shkelur të drejtat dhe liritë kushtetuese.
26. Nga kjo rrjedh se, kërkesa është qartazi e pabazuar, në pajtim me rregullin 36 (2b) të Rregullores së punës, i cili parasheh „Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se: b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk arsyetojnë pretendimin për shkeljen e të drejtave kushtetuese.“

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 36 (2b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 2 korrik 2012, njëzëri


VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtar raportues



Snezhana Botusharova



Kryetar i Gjykatës Kushtetuese



Prof. Dr. Enver Hasani